



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 73 , datë 27.12.2007

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.15,
DATË 10.03.2004, SI DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KËSHILLIT BASHKIAK NR.33, DATË 01.07.2004”**

Bazuar në ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 19, pika 9, neni 32, gërma “dh”, “ç”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.33, date 01.07.2004 “Për miratimin e Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.15, datë 10.03.2004, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë një shtesë prej 8 punonjësish në sektorin e mirëmbajtjes së shkollave nga të cilët, 1 inxhinjer mekanik dhe 7 teknikë në strukturën organizative të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit për vënien në funksionim dhe mirëmbajtjen e impianteve ngrohëse në objektet arsimore.
2. Pika 3 e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.15, datë 10.03.2004, ndryshon nga 76 në 84.
3. Këta punonjës do të paguhen sipas lidhjes Nr.4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.61, datë 30.11.2007.
4. Efektet financiare për vitin 2007 të kësaj shtese, do të përballohen brenda buxhetit të miratuar për Drejtorinë Nr.3 të punëtorëve të Qytetit.
5. Në kapitullin 2 “Aktiviteti i Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit”, paragrafi i parë, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.33, datë 01.07.2004, të shtohet shprehja:
“Vënie në funksionim dhe mirëmbajtjen e impianteve ngrohëse në institucionet shkollore dhe parashkollore të qytetit të Tiranës”.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R I